

REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
REJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOB
Lokale / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 09 Nr. Faqeve. 1
Org. Prot. Br. Prot. Br. Stranica

REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.09
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 40.2 (d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 36.1 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës me datën 31.01.2025 miratoi:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ORARIT TË MBLEDHJEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025.

I

Mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës për Vitin 2025 do të mbahen sipas këtij orari :

1.	31	Janar	2025	e Premte,
2.	28	Shkurt	2025	e Premte,
3.	31	Mars	2025	e Hane,
4.	30	Prill	2025	e Mërkure,
5.	30	Maj	2025	e Mërkure,
6.	30	Qershor	2025	e Hane,
7.	31	Korrik	2025	e Enjte,
8.	29	Gusht	2025	e Premte,
9.	30	Shtator	2025	e Marte,
10.	31	Tetor	2025	e Premte,
11.	28	Nëntor	2025	e Premte,
12.	30	Dhjetor	2025	e Marte,

II

Përveç mbledhjeve të rregullta të parapara në pikën (I) të këtij vendimi, Kuvendi i Komunës në Ferizaj do të mbajë edhe këto 3 mbledhje solemne dhe atë:

1. 17 Shkurt - 2022 - Dita e Pavarësisë,
2. 12 Qershor - 2022 - Dita e Çlirimit dhe
3. 28 Shtator - 2022 - Dita Komunale e Dëshmorëve,

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dilalese / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 10 Nr. Faqeve. 2
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.10
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, konform Rregullorës për Ndarjen e Subvencioneve, neni 21 dhe 21.1, Rregullore e miratuar nga Kuvendi i Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE NË LËMIN E BUJQËSISË PËR VITIN 2025

I

Me këtë vendim miratohet kërkesa Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë për ndarjen subvencioneve në lëmin e bujqësisë në Komunën e Ferizajt.

II

Subvencionet e përmendura në pikën një të këtij vendimi do të ndahen si në tabelën më poshtë:

Arsyeshmëria e realizimit të subvencioneve nga Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2025

Nr.	Shpërndarja e buxhetit	Vlera sipas Buxhetit/ €	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit
	SUBVENCIONET		
1	Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor	170,000.00	10.03.2025
2	Subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit për litër qumështi të prodhuar	90,000.00	10.07.2025(bëhet thirrja publike për aplikim)
3	Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra dhe jashtë tyre me pajisje	170,000.00	15.03.2025
4	Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	70.000.00	Pa procedurë të prokurimit (pranimi i kërkesave bëhet gjatë gjithë vitit)

Gjithsej vlera e subvencioneve 500,000.00

1. **Subvencionimi i fermerëve me mekanizim bujqësor** – Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2025 do të subvencionojë fermerët me mekanizim të ri bujqësor, mekanizimi i ri bujqësor është mjeti i domosdoshëm për zbatimin e masave agroteknike të gjitha kulturat bujqësore, Meqë është mjet i domosdoshëm, ai ndikon direkt në uljen e kostos së prodhimit dhe rritjen e të hyrave të qëndrueshme për ekonomitë familjare që mirren me këtë veprimtari. Vlera e tërësishme e këtij projekti do të jetë 170,000.00€
2. **Subvencionimi i fermerëve prodhues të qumështit për liter qumështi të prodhuar** - Duke marr vazhdimisht të dhëna nga terreni për Sektorin e blegtorisë dhe analizuar me kujdes mbi gjendjen e vështirë të prodhuesve të qumështit, Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2025 do të bëjë subvencionimin e qumështit të prodhuar për 6 mujorin e parë të Vitit 2025 me vlerën prej 0.10 cent për liter të prodhuar, procesi i subvencionimit do të bëhet përmes thirrjes publike për të gjithë prodhuesit e qumështit aplikues për sasi dhe cilësi të qumështit në Mbzhr.
3. **Subvencionimi i fermerëve kultivues të perimeve në serra me paisje** - Duke marr për bazë kërkesat e shumta të fermerëve dhe duke parë rëndësinë e kultivimit të kulturave bujqësore në serra dhe jashtë tyre Drejtoria për Bujqësi këta kultivues këtë vit do t'i subvencionojë me paisje – mekanizim bujqësor për kryerjen e punëve në serra dhe jashtë tyre. Kultivimi i perimeve në serra dhe jashtë tyre kërkon angazhim të madh të fuqisë punëtore dhe pajisjet siç janë motokultivatorët me frezë e lehtësojnë dukshëm veprimtarinë e kësaj kategorie duke zvogëluar angazhimin e fuqisë punëtore, bazuar në mundësitë buxhetore, Drejtoria për Bujqësi për Vitin 2025 ka paraparë që të ndajë 170,000.00 € për realizimin e këtij projekti.
4. **Kompenzimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore** – Bujqit në përgjithësi ballafaqohen me dëme që iu shkaktohen nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore si nga reshjet e shiut, breshërit, vërshimet, përmytjet dhe nga fatkeqësitë tjera si nga zjarri, ngordhjet të kafshët e trasha dhe të imëta, dëmet në bletishte etj., meqë shumica dërmuese e bujqëve nuk i kanë të siguruar kulturat bujqësore dhe gjënë e gjallë (lopë, dele, dhi etj.), Drejtoria për Bujqësi në bazë të mundësive të saj buxhetore edhe këtë vit ka ndarë një buxhet në vlerë prej 70,000.00€ për kompenzimin e pjesërishëm të këtyre dëmeve, kompensimi do të bëhet në bazë të vlerësimit profesional të komisionit të krijuar nga ana e Drejtorisë për Bujqësi.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa dhe Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
Drejtoria e Administratës dhe Personelit • Uprava Administracije i Osoblja		
Dilese / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025		
Nr. Orgv. Org. jed: 01	Nr. Prot. Br. Prot.: 11	Nr. Faqeve. Br. Strana: 1



Ferizaj - Uroševac

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY01.Nr.11
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës Ferizaj Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM**PËR RISHQYRTIM TË VENDIMIT ME NR.01.91 TË DATËS 27.09.2024****I**

RISHQYRTOHET: Vendimi me numër 01.Nr.91 i datës 27.09.2024 përmes së cilit është shpallur interes i përgjithshëm ngastra kadastrale 2037-0 Z.K. Jezerc me sipërfaqe 348m², vetëm sa i përket pikës së IV të vendimit ku prona ishte në hipotek dhe tani është liruar nga hipoteka dhe ndaj kësaj parcele nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësorë.

II

Të gjitha pikat tjera të vendimit që nuk preken me këtë vendim, mbesin në fuqi.

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
Drejtoria e Administratës dhe Personelit • Uprava Administracije i Osoblja
Dilse / Izlaze: Date / Dana: 05/02/2025
Nr. Org. Org. jed: 0 Nr. Prot. Prot. jed: 12 Nr. Faqeve: 1
Ferizaj • KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.12
Data: 31.01.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, të Ligjit Nr. 03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NËVOJA TË
FSHATIT MUHAXHER.**

I

Lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin Muhaxher caktohet në parcelën kadastrale 114-0 Z.K. Muhaxher me sipërfaqe prej 150 m2, pronë e Komunës së Ferizajt.

II

OBLIGOHE: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedisit të lëshoj leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Muhaxher.

III

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e Fshatit Muhaxher.

IV

OBLIGOHE: Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e Fshatit Muhaxher, ashtu siç e Parashih Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

V

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Degr. / Origj: 01 Nr. Prot. / Br. Prot. 13 Nr. Fageve. / 1
REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNES
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.13
Data: 31.01.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, Ligji Nr.03/L-040, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15 Qershor 2008), Rregullore (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe Rregullore (Qrk) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (Qrk) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave lista I, shtojca II pika 8, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT PËR NËVOJA TË FSHATIT ZASKOK.

I

Lokacioni për ndërtimin e objektit në Fshatin Zaskok caktohet në pjesën e parcelës kadastrale 328-0 Z.K. Zaskok me sipërfaqe prej 1520 m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Pjesa tjetër e parceles 328-0 ZK. Zaskok me sipërfaqe prej 271 m² do të shërbej për rrugë dhe për qasjen e parcelave të tjera në rrugë.

III

OBLIGOHE: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedis të lëshojë leje ndërtimore për ndërtim të objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Zaskok.

IV

Ndërtimi dhe financimi për ndërtimin e objektit do të bëhet nga banorët e Fshatit Zaskok.

V


OBLIGOHE: Kryetari i Komunës që të lidhë marrëveshje të veçantë për përcaktimin e mënyrës së shfrytëzimit të këtij objekti me Kryetarin e Fshatit Zaskok, ashtu siç e parasheh Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për Organizimin, Funksionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, neni 9 paragrafi 1, pika 1 deri 5.

VI

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Mjedisit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIC OF KOSOVO • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLI
Kalese - Izlaze: Date / Dana: 05/02/2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 14 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana. 1
Ferizaj • Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.14
Data: 31.01.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me Nr.03/L-040, Ligjit Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko - Privat neni 2 pika 1.7, neni 3 pika 1.12.1 dhe neni 11, Ligji Nr. 06/L092 neni 5 pika 1.3 neni 8 pika 1.3, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJËS SË BASHKËPUNIMIT DHE BASHKËFINANCIMIT MES KOMUNËS SË FERIZAJT DHE CARITAS KOSOVA.

I

MIRATOHET: Marrëveshja e bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit në mes të Komunës së Ferizajt dhe Caritas Kosova.

II

Marrëveshja ka për qëllim vazhdimin e funksionalizimit të Kopshtit "Engjujt" në Lagjen e Re në Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt dhe funksionimi i Qendrës Sociale, Edukative "Caritas Kosova" në Dubravë të Ferizajt.

III

Kjo marrëveshje prodhon efekt juridik nga data 01.02.2025 dhe skadon me 31.01.2027.

IV

Për zbatimin e kësaj marrëveshje përkujdeset Drejtoria e Arsimit si dhe Kryetari i Komunës Ferizaj.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
HEJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Udhese - Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 15 Nr. Faqeve. 2
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPSTINA UROSEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNES
SKUPSTINA OPSTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.15
Data: 31.01.2025

Në bazë të dispozitave nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr. 03/L-139 me ndryshime dhe plotësime të Ligjit Nr. 03/L-205 të datës 28.10.2010, nenit 24 paragrafi 4 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, paragrafi 5 i nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR KËMBIMIN E NGASTRAVE KADASTRALE: 692-4, 694-2 DHE 693-3 Z.K.PRELEZ I JERLIVE PRONË PRIVATE, ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 1178-0Z.K.PRELEZ I JERLIVE, PRONË E KOMUNËS SË FERIZAJT.

I

Ngastrat kadatsrale:

- 694-4 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 31 m², pronë e Mehmet dhe Indira Mustafa.
- 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 33 m², pronë e Gazmen Mustafa dhe
- 694-2 Zk. Prelez i Jerlive me sipërfaqe prej 149 m², pronë Gazmen Mustafa.

Këmbehen me:

- 1178-0 Z.K. Prelez i Jerlive me sipërfaqe prej 213m², pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Pronat private të lartëcekura janë shpallur interes i përgjithshëm me Vendim të kuvendit me Nr. 01.Nr.37 i datës 30.05.2024 në bazë të atij vendimi është bërë edhe vlerësimi nga Ministria e Financave respektivisht Departamenti i Tatimit në pronë, ku parcela e komunës me Nr.1178-0 Z.K.Prelez i Jerlive me sipërfaqe prej 213m² është vlerësuar 35.00€ për m², ndërsa parcelat private: -694-2 ZK. Prelez i Jerlive me sipërfaqe prej 149 m², 693-3 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 33 m², 694-4 Z.K. Prelez i Jerlive, me sipërfaqe prej 31 m², po ashtu me nga 35.00€ për m².

III

Pronat e lartëcekura këmben me qëllim të rregullimit të parcelave si dhe më këtë këmbim krijohen kushte më të lehta për qasje të parcelave me të cilat kufizohen, në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

IV

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike të zbatimit të tij.

V

Për realizimin e këtij Vendimi përkujdeset Drejtoria për Gjeodezi Pronë dhe Kadastër në Ferizaj

VI

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 16	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.16
Data: 31.01.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/15 Qershor 2008), nenit 24 të Ligjit Nr.06/L- 092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës 7 Mars 2019, neni 29 pika 1, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

**PËR KËMBIMIN E NGASTRAVE KADASTRALE 1140-2 Z.K.FERIZAJ PRONË PRIVATE,
ME PJESËN E NGASTRËS KADASTRALE 3280-0 Z.K.FERIZAJ PRONË E KOMUNËS SË
FERIZAJT.**

I

Pjesa e ngastrës kadastrale:

1140-2 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 605 m², pronë e Xhylsime (Isuf) Aliu ½ dhe Asime (Adem) Ramadani ½.

Këmbehet me:

Pjesën e ngastrës kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 572 m² pronë e Komunës së Ferizajt.

II

Pronat të cilat të këmbehen janë të regjistruara: parcela 3280-0 Z.K. Ferizaj me sipërfaqe prej 572 m² në pronësi të Komunës së Ferizajt dhe parcela kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj, me sipërfaqe prej 605 m² Z.K. Ferizaj në pronësi me sipërfaqe prej Xhylsime (Isuf) Aliu ½ dhe Asime (Adem) Ramadani ½. Në këto parcela nuk ka ndonjë barrë apo kontest pronësor.

III

Pronat e përshkruara më lartë këmbehen me qëllim të hapjes së rrugës së re “Ali Beqa” në Ferizaj.

IV

Pronat të cilat këmbehen janë shpallur interes i përgjithshëm sipas vendimit të Kuvendit të komunës me Nr. 01. Nr. 90, datë 27.09.2024, në bazë të të cilit vendim është bërë vlerësimi i pronave nga Ministria e Fianancave – Departamenti i Tatimit në Pronë, parcela kadastrale 3280-0 Z.K. Ferizaj, pronë e komunës është vlerësuar 370.00 € për m², prona private- parcela kadastrale 1140-2 Z.K. Ferizaj është vlerësuar 350.00 € për m², andaj në bazë të vlerësimit këmbimi paluejtshmërive do të bëhet ashtu siç është përcaktu në nenin 1 të këtij vendimi.

V

Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara më lartë do të evidentohen ne librat kadastral. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra komunale kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.

VI

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Ferizaj.

VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLICA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBILIA
Klase / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv: 01 Nr. Prot.: 17 Nr. Faqeve: 1
Org. jed: Br. Prot.: Br. Strana: 1
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.17
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPARENCË DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË KOMUNALE PËR VITIN 2025-2028

I

MIRATOHET: Rregullorja për Transparencë dhe Planin e Veprimit për Transparencë Komunale për Vitin 2025-2028

II

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe dokumenti i detajuar i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale për Vitin 2025-2028

III

Për realizimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kuvendi i Komunës, Drejtoria e Administratës Ferizaj si dhe Kryetari i Komunës së Ferizajt.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

REPUBLICA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Udhëse / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 18 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.18
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 si dhe Ligjit Nr. 04/L-074 për sistem të adresave, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR: 40 TË DATËS 30.05.2024 PËR KOMISIONIN E EMËRTIMIT TË RRUGËVE, RRUGICAVE DHE SHESHEVE PËR KOMPLETIMIN E SISTEMIT TË ADRESAVE NË KOMUNË.

I

Me këtë Vendim Plotësohet - Ndryshohet Vendimi me Nr: 40 i datës 30.05.2024 vetëm sa i përket anëtarit të Komisionit, ku në vend të:

Artin Jashari, emërohet Besa Haxhimusa.

II

Të gjitha pikat tjera të Vendimit me Nr: 40 i datës 30.05.2024 mbesin në fuqi.

III

Për realizimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës Ferizaj, si dhe Drejtoria e Urbanizmit Ferizaj.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DEJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA
Dalese / Izlaze: Date / Dana: 05.02.2025
Nr. Orgv. 01 Nr. Prot. 19 Nr. Faqeve. 1
Org. jed. Br. Prot. Br. Strana.
Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.19
Data: 31.01.2025

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2025 miratoi këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NR. 01. NR. 04 TË DATËS 27.12.2024

I

Me këtë vendim plotësohet-ndryshohet Vendimi me Nr. 01. Nr. 04 të datës 27.12.2024 përmes së cilit është Shpallur Interesi i Përgjithshëm pjesa e ngastrës Kadastrale 275-3 Z.K.Gërlicë e ulët pronë private me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 275-2 Z.K.Gërlicë e ulët.

II

Me këtë vendim ndryshohet vetëm preambula e Vendimit me numër 04 i datës 27.12.2024 vetëm sa i përket numrit të parcelës ku në vend të 275-2 Z.K.Gërlicë e ulët, plotësohet-ndryshohet me 274-2 Z.K.Gërlicë e ulët.

III

Pikat tjera të Vendimit Nr. 01.Nr. 04 të datës 27.12.2024 të cilat nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Dejtoria e Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

